



PRANUAR ME:

ACCEPTED ON:

PRIMLJENO:

Mr No Br:

18/09/2026

02/259



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E MALISHEVËS



Kryetari i Komunës

Nr. 01/

Datë: 18.09.2026

Mbështetur në nenin 43 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 3 paragrafi 1 pika 1.2, nenit 5 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.02/2015, për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, nenit 13 të Rregullores nr.02/175 datë:31.05.2017 për punën e Kuvendit, Komiteteve dhe Komisioneve të Komunës së Malishevës në bazë të Statutit të Komunës së Malishevës, miratuar në mbledhjen e Kuvendit të Komunës me datë, 11.09.2023 (nr.02/441, datë: 14.09.2023),

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Malishevës, me datë: 18.09.2026;

THËRRET

Mbledhjen e -VI- (gjashtë) e rregullt të Kuvendit të Komunës së Malishevës për vitin 2026, e cila do të mbahet ditën e Marte me datë: 29.09.2026 duke filluar nga ora: 09:30.

Mbledhja do të mbahet në sallën e Kuvendit të Komunës së Malishevës.

Ftohet z/zi _____ që të marrë pjesë në këtë mbledhje.

Për këtë mbledhje propozoj këtë:

RENDITËS

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së pestë të rregullt nga mbledhja e kaluar mbajtur me datë, 22.07.2026.
2. Shqyrtimi i kërkesës së Drejtorisë për Urbanizëm, nr.05/266, dt.01.06.2026, për marrjen e Pëlqimit për harmonizimin e vendimit sipas Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës dhe vënien nën mbrojtje të Monumentit të Natyrës “ Rrjedha e lumit Mirusha “ konform propozimit profesional të grupit punues.
3. Shqyrtimi dhe miratimi i draft Buxhetit për Komunën e Malishevës 2027/2029, me theks të veçante për vitin 2027, nr.04/481, dt.31.08.2026.
4. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Malishevës për vitin 2025, i Zyrës Kombëtare të Auditimit.
5. Shqyrtimi i Raportit të performancës së Komunës së Malishevës për vitin 2025.
6. Shqyrtimi i parashtrësës së kryetarit të komunës nr.01/1599, dt.15.09.2026, në lidhje me kërkesën e drejtorisë për urbanizëm për iniciimin e hartimit të Planit Zhvillimor Komunal 2027-2039 dhe Hartës Zonale të Komunës s Malishevës.

7. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit të kryetarit të komunës së Malishevës, për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës së Malishevës në shfrytëzim afatshkurtër përmes ankandit publik, deri në 15 (pesëmbëdhjetë) vite, për organizatat e shoqërisë civile me qëllim të organizimit dhe funksionalizimin e “ Qëndrimit ditor për të moshuar, kuzhinës humanitare dhe qendrës për fëmijë me nevoja të veçanta shëndetësore”.
8. Formimin e komisionit vlerësues me rastin e dhënies në shfrytëzim të pronës publike përmes ankandit publik deri 15 (pesëmbëdhjetë) vite.
9. Shfuqizimi i Vendimit nr.02/230, dt.29.07.2026, konform shkresës nr.02/4438-2/26, dt.31.08.2026, të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit hapësinorë, në lidhje me miratimin e kërkesës nr.01/12/15, dt.08.01.2026, të parashtruar nga K.R.M “ Ekoregjioni “ sh.a në Prizren.
10. Rishqyrtimi i Vendimit të Kuvendit të Komunës së Malishevës, nr.02/224, dt.22.07.2026, në lidhje me iniciimin e procedurave administrative për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës publike deri në 15 vite përmes procedurës së ankandit publik.
11. Rishqyrtimi i Vendimit të Kuvendit të Komunës së Malishevës, nr.02/226 ,dt.22.07.2026, për formimin e Komisionit Vlerësues për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës publike deri në 15 vite përmes procedurës së ankandit publik.
- 12.Rishqyrtimi i Vendimit të Kuvendit të Komunës së Malishevës, nr.02/225, dt.22.07.2026, Vendimi përfundimtar për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës së Malishevës përmes procedurave të shprehjes së interesit publik.
13. Rishqyrtimi i Vendimit të Kuvendit të Komunës së Malishevës, nr.02/221, dt.22.07.2026, Vendimi përfundimtar për dhënien në shfrytëzim afatgjatë deri 30 (tridhjetë) vite, të pronës së paluajtshme të komunës së Malishevës për subjektin afarist “ Pashtriku “ me menaxher drejtues z.Afrim Gigollaj.
- 14 Shqyrtimi i Raportit të Komisionit të formuar sipas Vendimit, nr.01/1590, dt.11.09.2026.
- 15.Shqyrtimi i kërkesës nr.02/201, dt.10.07.2026, e parashtruar nga z.Ardian Aziz Telaku nga fshati Banjë, Komuna e Malishevës, për këmbimin e pronës private me pronë publike.
- 16.Të ndryshme

Ardhja e juaj është e obligueshme!

Malishevë, shtator 2026

Kryesuesi i Kuvendit
Fatmir Ademaj



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
 MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR
 MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA
 MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANING

Njësia Org. Org.Jedinica Org.Unit **DMM AMMK**

Nr. ffaqeve Broj.stranica No.pages

Nr.Prot. Broj.Prot. Prot.No **309-2/25**

Data Datum: **02.06.2026**

Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic Of Kosovo

Komuna e Malishevës

Opštine Mališevo - Municipality of Malisheva



Datë/a:	01.06.2026
Referenc-ë:	
Për/ Za/ To:	Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës Departamenti i Mbrojtjes së Mjedisit dhe Ujërave
CC:	
Përmes/Preko/Through:	
Nga/ Od/ From:	z. Avdi Morina, drejtor i drejtorisë së Urbanizmit- Komunës së Malishevës
Tema/ Subjekat/Subject:	Kërkesë për pëlqim për harmonizimin e vendimit sipas Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës dhe vënien nën mbrojtje të Monumentit të Natyrës "Rrjedha e lumit Mirusha", konform Propozimit Profesional të grupit punues.

Bazuar në Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës nr. 03/L-233, neni 19, paragrafi 3, Komuna e Malishevës kërkon pëlqim nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës për harmonizimin e vendimit sipas Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës dhe vënien nën mbrojtje të Monumentit të Natyrës "Rrjedha e lumit Mirusha", konform Propozimit Profesional të grupit punues ndërinstitucional, në bashkëpunim me Komunën e Malishevës.

Grupi punues, i udhëhequr nga Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës, në bashkëpunim me akterë të tjerë, duke përfshirë edhe Komunën e Malishevës, gjatë vitit 2024 ka përgatitur Propozimin Profesional për gjendjen në Monumentin e Natyrës "Rrjedha e lumit Mirusha" dhe harmonizimin e vendimit me Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës. Në bazë të këtij propozimi, Kuvendit Komunal të Malishevës i është propozuar nxjerrja e një vendimi të ri për Monumentin e Natyrës "Rrjedha e lumit Mirusha", konform këtij propozimi profesional, i cili bazohet në vlerat dhe gjendjen në terren të konstatuar nga grupi punues.


Pas hartimit të Propozimit Profesional, Kuvendi Komunal i Malishevës ka nxjerrë Vendim për hapjen e debatit publik me afat kohor prej 30 ditësh, nga data 05.05.2025 deri më 04.06.2025, lidhur me vlerat e trashëgimisë natyrore në Monumentin e Natyrës "Rrjedha e lumit Mirusha", dhe nuk ka pranuar asnjë sugjerim apo plotësim nga opinioni publik.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic Of Kosovo

Komuna e Malishevës
Opštine Mališevo - Municipality of Malisheva

PRANUAR MË:
ACCEPTED ON: 01/06/2026
PRIMLJENO:
05/06/2026



Datë/a:	01.06.2026
Referenc-ë:	
Për/ Za/ To:	Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastruktur Departamenti i Mbrojtjes së Mjedisit dhe Ujërave
CC:	
Përmes/Preko/Through:	
Nga/ Od/ From:	z. Avdi Morina, drejtor i drejtorisë së Urbanizmit- Komunës së Malishevës
Tema/ Subjekat/Subject:	Kërkesë për pëlqim për harmonizimin e vendimit sipas Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës dhe vënien nën mbrojtje të Monumentit të Natyrës "Rrjedha e lumit Mirusha", konform Propozimit Profesional të grupit punues.

Bazuar në Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës nr. 03/L-233, neni 19, paragrafi 3, Komuna e Malishevës kërkon pëlqim nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës për harmonizimin e vendimit sipas Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës dhe vënien nën mbrojtje të Monumentit të Natyrës "Rrjedha e lumit Mirusha", konform Propozimit Profesional të grupit punues ndërinstitucional, në bashkëpunim me Komunën e Malishevës.

Grupi punues, i udhëhequr nga Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës, në bashkëpunim me akterë të tjerë, duke përfshirë edhe Komunën e Malishevës, gjatë vitit 2024 ka përgatitur Propozimin Profesional për gjendjen në Monumentin e Natyrës "Rrjedha e lumit Mirusha" dhe harmonizimin e vendimit me Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës. Në bazë të këtij propozimi, Kuvendit Komunal të Malishevës i është propozuar nxjerrja e një vendimi të ri për Monumentin e Natyrës "Rrjedha e lumit Mirusha", konform këtij propozimi profesional, i cili bazohet në vlerat dhe gjendjen në terren të konstatuar nga grupi punues.

Pas hartimit të Propozimit Profesional, Kuvendi Komunal i Malishevës ka nxjerrë Vendim për hapjen e debatit publik me afat kohor prej 30 ditësh, nga data 05.05.2025 deri më 04.06.2025, lidhur me vlerat e trashëgimisë natyrore në Monumentin e Natyrës "Rrjedha e lumit Mirusha", dhe nuk ka pranuar asnjë sugjerim apo plotësim nga opinioni publik.

Bazuar në Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës nr. 03/L-233, neni 19, paragrafi 3, Komuna e Malishevës kërkon pëlqim nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës për pikat në vijim:

1. Zonat kadastrale dhe sipërfaqen e zonës së mbrojtur;
2. Paraqitjen hartografike të zonës së mbrojtur, të dhëna këto të prezantuara në Propozimin Profesional të bashkëngjitur kësaj kërkesë për pëlqim.

Kërkesës i bashkëngjiten:

1. Propozimi Profesional për gjendjen në Monumentin e Natyrës "Rrjedha e lumit Mirusha" dhe harmonizimin e vendimit me Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës për zonën e mbrojtur;
2. Harta e zonave të mbrojtura (pjesë e arsytimit).



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO			
MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR			
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA			
MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANING			
Njësia Org Org.Jediniça Org.Unit	SP-02	Nr.Prot Broj.Prot Prot.No.	509-2/26
Nr. ftoçve Broj.stranica No pages	03	Data Datum Date	03, 07, 2026
PRISTINE/A			

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelaria Permanentni Sekretara / Office of the General Secretary

DATE/A:	01.07.2026
REFERENC-Ë:	509-2/26, 02.06.2026 MMPH /492/DMM
PËR/ZA/TO:	Z. Avdi Morina, drejtor i drejtoris së Urbanizmit në Komunën e Malishevës
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	z. Bajram Kafexholli – UD. i Sekretarit të Përgjithshëm MMPH
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Pëlqim paraprak

Sipas kërkesës me numër protokolli Nr. 509-2/26, 02.06.2026 MMPH dhe me numër protokolli Nr.492 DMM, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ka shqyrtuar kërkesën dhe ka vendosur si në vijim me Vendimin e bashkangjitur.

Me respekt,



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, në mbështetje të nenit 145 paragrafi 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Shtetërore, duke u bazuar në Nenit 19 të Ligjit Nr.03/L-233 për Mbrojtjen e Natyrës, në pajtim me shtojcën 1 pika 10 të Rregullores (QRK) Nr.14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nxjerr:

V E N D I M

Në kërkesën e z. Avdi Morina, drejtor i drejtoris së Urbanizmit në Komunën e Malishevës për pëlqim për Monumentin e Natyrës “Rrjedha e Lumit Mirusha” dhe harmonizimin e Vendimit me Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës. Me numër protokolli Nr.509-2/26, 02.06.2026 MMPH, nr. protokolli Nr.492/DMM.

DMM-ja me datë 08.06.2026 ka kërkuar Informata shtese nga Komuna e Malishevës dhe IKMN-ja për plotësimin e Arsyeshmëris profesionale për pëlqim për Monumentin e Natyrës “Rrjedha e Lumit Mirusha” dhe harmonizimin e Vendimit me Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës:

Pas pranimit të informatave shtesë nga IKMN-ja me datë 22.06.2026 janë prezantuar dokumentacioni dhe shënimet të nevojshme në bazë të Nenit 14 dhe Nenit 19 paragrafi 3 të Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës, Nr. 03/L-233.

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor **jep Pëlqim paraprak** për “Rrjedhën e Lumit Mirusha” dhe harmonizimin e Vendimit me Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës, Nr. 03/L-233.

Faqe 2 nga 3



Arsyetim

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, pas shqyrtimit të kërkesës me Nr. 509-2/26, 02.06.2026 MMPH dhe Nr.492/DMM për Pëlqim paraprak për marrje nën mbrojtje të vlerave të natyrës në kategorinë Monumente të Natyrës në Komunën e Malishevës, janë prezantuar dokumentet dhe shënimet e nevojshme sipas Nenit 14 dhe Nenit 19 paragrafi 3. të Ligjit Nr. 03/L-233 për Mbrojtjen e Natyrës.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nxjerrjes.

Udhëzim Juridike: Kundër këtij Vendimi pala e pakënaqur mund të inicoj konflikt administrativ me padi në Gjykatën Themelore në afat 30 ditësh nga dita e pranimit e të njejtit.

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

Nr.: 26/ 509-2/1 - ZSP/

/26 datë: 01.07.2026

Prishtinë

T'i dërgohet:

1. Parashtruesit të kërkesës
2. DMM/DMNB
3. AMMK/IKMN
4. Kabinetit të Ministrit
5. Arkivit të MMPHI
6. DKP
7. Divizionit për Leje dhe Licenca Mjedisore

Bajram Kafexholli

U.d. i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPH-së

Faqe 3 nga 3

PRANUAR ME: 15/09/2026
ACCEPTED ON:
PRIMLJENO:
MeMe: 01/1599

REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI KOMUNËS NË MALISHEVË

Kryetari i Komunës

Nr. 01/

Datë: 14/09/2026

Nga: *for* Kryetari i Komunës së Malishevës, Ekrem Kastrati.

Për: Kuvendin e Komunës së Malishevës.
Kryesuesit z.Fatmir Ademaj.

Datë: 14.09.2026

Kopje: Arkivit të komunës

Lënda: *Përcjellje e kërkesës nr.05/427 ,dt.10.09.2026, të parashtruar nga Drejtoria për Urbanizëm, për inicimin e hartimit të Planit Zhvillimor Komunal 2027–2035 dhe Hartës Zonale të Komunës së Malishevës 2027–2035.*

I nderuar Kryesues,

Në mbështetje të kompetencave ligjore të Komunës së Malishevës dhe me qëllim të fillimit të procedurave për planifikimin e zhvillimit hapësinor dhe urban të territorit të Komunës, ju përcjellim për shqyrtim dhe procedim në Kuvendin e Komunës kërkesën e Drejtorisë së Urbanizmit nr.05/427, dt.10.09.2026, për inicimin e hartimit të Planit Zhvillimor Komunal (PZHK) 2027–2035 dhe Hartës Zonale të Komunës së Malishevës 2027–2035.

Kërkesa e lartcekur paraqet nevojën për fillimin e procedurave për hartimin e dokumenteve të planifikimit hapësinor, të cilat do të shërbejnë si bazë për orientimin dhe menaxhimin e zhvillimit të ardhshëm hapësinor, ekonomik, social, infrastrukturor dhe mjedisor të territorit të Komunës së Malishevës.

Duke pasur parasysh rëndësinë e këtyre dokumenteve për zhvillimin e qëndrueshëm të Komunës dhe ushtrimin e përgjegjësisë së saj në fushën e planifikimit hapësinor, kërkohet që kjo çështje të shqyrtohet dhe të procedohet për vendimmarrje nga Kuvendi i Komunës së Malishevës, në pajtim me kompetencat dhe procedurat e përcaktuara me legjislacionin në fuqi.

Bashkëlidhur kësaj shkrese ju përcillet kërkesa e Drejtorisë së Urbanizmit, së bashku me dokumentacionin përkatës, për shqyrtim dhe ndërmarrjen e veprimeve të mëtejshme procedurale.

Ju faleminderit për mirëkuptim!

Me respekt,



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E MALISHEVËS
DREJTORIA E URBANIZMIT



Për: Z. Ekrem Kastratit kryetar i komunës të Malishevës

Nga: Drejtoria e Urbanizmit

Lënda: Kërkesë për iniciimin e hartimit të Planit Zhvillimor Komunal 2027-2035 dhe Hartës Zonale të komunës 2027-2035

Datë: 08.09.2026

I nderuar Kryesues i Kuvendit Komunal, të nderuar asamblistë,

Drejtoria e Urbanizmit, duke marrë parasysh nevojën për planifikim të qëndrueshëm dhe të harmonizuar hapësinor të territorit të Komunës së Malishevës, paraqet këtë kërkesë për nxjerrjen e Vendimeve për hartimin e Planit të ri Zhvillimor Komunal (PZHK) dhe Hartës së re Zonale të Komunës (HZK).

Komuna e Malishevës ka miratuar Planin Zhvillimor Komunal në vitin 2019. Procesi i hartimit të këtij dokumenti kishte filluar disa vite më herët dhe një pjesë e konsiderueshme e të dhënave dhe parametrave të përdorur në të bazohen në gjendjen e atëhershme dhe në të dhënat e regjistrimit të popullsisë të vitit 2011.

Që nga miratimi i PZHK-së e deri më tani, në territorin e Komunës së Malishevës kanë ndodhur ndryshime të rëndësishme demografike, ekonomike, sociale, infrastrukturore dhe hapësinore. Po ashtu, Komuna ka ndërmarrë një sërë zhvillimesh dhe ka marrë vendime me rëndësi për zhvillimin e territorit, të cilat nuk janë të reflektuara në dokumentin aktual të planifikimit.

Ndër zhvillimet e rëndësishme mund të përmenden ndërtimi i nënstacionit të energjisë elektrike, ndërtimi i çerdhes në Kijevë, caktimi i lokacionit për varrezat publike të qytetit, ndërtimi dhe planifikimi i objekteve të ndryshme publike dhe komunale, caktimi i lokacionit për deponinë e mbeturinave, si dhe vendime të tjera që kanë ndikuar në mënyrën e shfrytëzimit dhe zhvillimit të territorit të komunës.

Gjithashtu, gjatë viteve të fundit janë paraqitur kërkesa dhe nevoja të reja për zhvillimin ekonomik dhe hapësinor të komunës, përfshirë investimet në energji të ripërtëritshme, zhvillimin e bujqësisë dhe fermave, zhvillimin e zonave ekonomike, infrastrukturën publike, zhvillimin urban dhe rural, si dhe projekte të tjera me rëndësi për zhvillimin e qëndrueshëm të Komunës së Malishevës.

Duke pasur parasysh kohën e kaluar nga hartimi i këtyre dokumenteve, ndryshimet e ndodhura në territorin e komunës dhe nevojën për planifikim të bazuar në të dhëna të përditësuara, konsiderohet e domosdoshme që Komuna e Malishevës të fillojë një proces të ri të planifikimit hapësinor.

Hartimi i PZHK-së dhe HZK-së së re do të mundësojë analizimin e gjendjes aktuale të territorit, përcaktimin e nevojave dhe prioritetëve të zhvillimit, planifikimin e infrastrukturës dhe shërbimeve publike, orientimin e investimeve, mbrojtjen e tokës dhe resurseve natyrore, si dhe krijimin e kushteve të qarta për zhvillimin ekonomik, urban dhe rural të komunës.

Dokumentet e reja do të hartohen duke u bazuar në të dhënat më të fundit në dispozicion, gjenden faktike në terren, nevojat e komunitetit, potencialet zhvillimore të komunës dhe kërkesat e legjislacionit në fuqi për planifikimin hapësinor.

Për këtë arsye, kërkojmë nga Kuvendi i Komunës së Malishevës:

-Të nxjerrë Vendimin për fillimin e hartimit të Planit të ri Zhvillimor Komunal (PZHK) 2027-2035 të Komunës së Malishevës;

-Të nxjerrë Vendimin për fillimin e hartimit të Hartës së re Zonale të Komunës së Malishevës 2027-2035;

Nxjerrja e këtyre vendimeve paraqet një hap të domosdoshëm për fillimin e një procesi të ri dhe gjithëpërfshirës të planifikimit hapësinor, me qëllim që Komuna e Malishevës të ketë dokumente të përditësuara, funksionale dhe të harmonizuara me nevojat dhe objektivat e zhvillimit të saj në periudhën e ardhshme.

Andaj, kërkojmë nga Kuvendi i Komunës së Malishevës që ta shqyrtojë dhe miratojë këtë kërkesë dhe të nxjerrë Vendimet për hartimin e Planit të ri Zhvillimor Komunal dhe Hartës së re Zonale të Komunës së Malishevës.

Me respekt,
Avdi Morina
Drejtor i Urbanizmit



PRANUAR ME:

ACCEPTED ON:

PRIMJENO:

15/09/2026

01/1597

REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI KOMUNËS NË MALISHEVË

Kryetari i Komunës

Nr. 01/___

Datë: 15/06/2026

Nga: Kryetari i Komunës së Malishevës, Ekrem Kastrati.

Për: Kuvendin e Komunës së Malishevës
Kryesuesit z.Fatmir Ademaj.

Datë: 15.06.2026

Kopje: Arkivit të komunës

Lënda: Kërkesë për formimin e komisionit vlerësues, me rastin e dhënies në shfrytëzim të pronës publike përmes ankandit publik deri në 15 (pesëmbëdhjetë) vite.

Të nderuar anëtarë të kuvendit të komunës së Malishevës,

Bazuar në Ligjin për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, Ligji, nr.06/L-092, dt.07.03.2019, neni 17, propozojë formimin e komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës publike përmes ankandit publik deri në 15 (pesëmbëdhjetë) vite.

Formimi i këtij komisioni vlerësues përbëhet prej pesë (5) anëtarësh, ku dy (2) anëtarë i propozon kryetari i komunës ndërsa dy (2) anëtarë i propozon kuvendi dhe një (1) anëtarë nga sektori jo qeveritar.

Ju faleminderit për mirëkuptim !

Me respekt,